

Deklarata e Vlerave Ushqimore sipas VKM 434/2018*

- Një përmbledhje se çfarë Operatorët e Biznesit Ushqimor **duhet** të përfshijnë në Deklaratën e Vlerave Ushqimore dhe informacione të tjera që mund të përfshijnë në mënyrë vullnetare

Informacioni i Detyrueshëm

Minimumi i Informacionit të detyrueshëm që duhet të përfshihet

Vlerat Tipike	Për 100g/ml
Energji	kJ/kcal
Yndyrna nga të cilat të ngopura	g g
Karbohidrate nga të cilat sheqerna	g g
Proteina	g
Kripë	g

Rregullat e Detyrueshme

- Vlerat ushqyese duhet të shënohen sipas renditjes së treguar në tabelë
- Informacioni duhet të jepet për **100 g/ml**
- Energjia duhet të jepet në rendin e kJ/kcal
- Të gjitha vlerat e tjera ushqyese duhet të jepen në g
- Në rastet kur vlera e energjisë ose sasia e vlerave ushqyese në një produkt është e papërfillshme, informacioni për këto elemente mund të zëvendësohet me deklaratën: **"Përmban sasi të papërfillshme të ..."** dhe të paraqitet pranë deklaratës së vlerave ushqyese, kur është e pranishme.
- Nëse një produkt nuk përmban kripë të shtuar, shumë pranë deklaratës së vlerave ushqyese mund të paraqitet një deklaratë që tregon se përmbajtja e kripës është ekskluzivisht për shkak të pranisë në mënyrë të natyrshme të natriumit.

Informacion shtesë

Deklarata mund të zgjerohet duke shtuar një ose më shumë përbërës ushqimorë

Vlerat Tipike	Për 100g/ml
Energji	kJ/kcal
Yndyrna nga të cilat të ngopura	g g
me një lidhje të pangopur me shumë lidhje të pangopura	g g
Karbohidrate nga të cilat sheqerna	g g
poliole niseshte	g g
Fibër	g
Proteina	g
Kripë	g
Vitamina dhe Minerale	Njësitë e specifikuar në Shtojcën XIII të VKM 434/2018 dhe % e Sasi Referencë

Rregulla Shtesë

- Vlerat ushqyese të theksuara me ngjyrë të **kuqe** janë të vetmet që mund të shtohen në deklaratë
- Nëse shtohen, ato duhet të jenë sipas renditjes së treguar; deklarimi i një prej vlerave ushqyese shtesë nuk do të thotë që duhet t'i deklaroni të gjitha
- Vitaminat dhe mineralet mund të përfshihen vetëm nëse janë të listuara në Aneksin XIII të VKM 434/2018 dhe janë të pranishme në sasi të konsiderueshme
- Vitaminat dhe mineralet duhet të deklarohen në njësitë e specifikuar në Aneksin XIII dhe duhet të tregojnë përqindjen e sasisë referuese (%) për 100 g.
- Pasi të deklarohet informacioni ushqimor i detyrueshme dhe informacioni shtesë, nuk mund të shtohen vlera ushqyese të tjera pasi tashmë **lista është e mbyllur**.
- Nëse deklarime të autorizuara ushqimore bëhen për vlera të tjera ushqyese, sasi të këtyre vlerave ushqyese duhet të deklarohen afër **por jo në tabelë**



Informacion ekstra mund të shtohet në Deklaratën e Detyrueshme Ushqimore në formën e "Për porcion" ose "Njësi konsumi" dhe/ose % Sasi Referencë

Shembull me "për porcion"/për "njësi konsumi"

Vlerat tipike	Për 100g	Për porcion* (2biskota)	Për Biskotë**
Energji	2065kJ 495kcal	640kJ 160kcal	320kJ 80kcal
Yndyrna nga të cilat të pangopura	22.3g 10.0g	6.8g 3.0g	3.4g 1.5g
Karbohidrate nga të cilat sheqerna	64.6g 18.8g	20.0g 5.8g	10.0g 2.9g
Proteina	6.7g	2.0g	1.0g
Kripë	1.0g	0.4g	0.2g

*Kjo pako përmban 10 porcione

**Kjo pako përmban 20 biskota

Shembull për %Njësi konsumi për 100g

Vlerat tipike	Për 100g	%Njësi konsumi për 100g
Energji	823kJ 195kcal	10%
Yndyrna nga të cilat të pangopura	2.6g 0.3g	4% 2%
Karbohidrate nga të cilat sheqerna	37.5g 1.6g	14% 2%
Proteina	4.5g	9%
Kripë	0.54g	9%

Sasi referencë për një të rritur mesatar (8400 kJ / 2000 kcal)



Disa vlera ushqyese të detyrueshme mund të përsëriten vullnetarisht në pjesën e përparme të ambalazhit

Shembuj për informacionin në pjesën e përparme të ambalazhit

Vetëm Energjia

Çdo lugë gjelle (15 g) përmban

Energji 201kJ 48kcal
2%

Sasi referencë për një të rritur mesatar (8400 kJ / 2000 kcal)
Vlerat tipike për 100g: Energji 1338kJ/323kcal

Energji +4

Çdo pako (400g) përmban

Energji	Yndyrna	Yndyrna të ngopura	Sheqerna	Kripë
201kJ 48kcal	19.6g	9.0g	4.0g	2.0g
2%	22%	45%	4%	33%

Sasi referencë për një të rritur mesatar (8400 kJ / 2000 kcal)
Vlerat tipike (siç shitet) për 100g: Energji 508kJ/121kcal

Rregullat për "Për porcion/Për njësi konsumi"

- Ky informacion mund të jepet gjithashtu, **por jo në vend të për 100g/ml**
- OBU është përgjegjës për vendosjen e sasisë së një porcioni/njësie konsumi
- Nëse një OBU zgjedh të japë informacion ushqimor për porcion, paketa duhet të japë një tregues të qartë të sasisë së porcionit dhe numrin e porcioneve në paketë
- Nëse një OBU zgjedh të japë informacion ushqimor për njësi konsumi, paketa duhet të japë një tregues të qartë të numrit të njësive të konsumit në pako.

Rregullat për %Sasi Referencë

- Sasi të referencë mund të jepen për 100g/ml, për porcion/njësi konsumi ose të dyja
- Nëse % sasisi referencë jepet për vlerat ushqyese të detyrueshme, ato duhet të bazohen në sasi të referencë që përcaktohet në Aneksin XIII - Pjesa B
- Nëse % sasi referencë jepet për vlerat ushqyese të detyrueshme, ajo duhet të shoqërohet me shënimin "**Sasi referencë për një të rritur mesatar (8400 kJ / 2000 kcal)**"

Rregullat për Pjesën e Përparme të Ambalazhit

- Informacioni ushqimor për pjesën e përparme të ambalazhit mund të deklarohet vetëm si energji ose energji plus yndyrna, yndyrna të ngopura, sheqer dhe kripë (energji + 4)
- **Energjia duhet të deklarohet gjithmonë si kJ/kcal për 100g/ml dhe mund të jepet edhe për porcion**
- Yndyrnat, yndyrnat e ngopura, sheqeri dhe kripa mund të deklarohen vetëm për porcion, me kusht që sasia e porcionit dhe numri i porcioneve në paketë të tregohen qartë dhe në mënyrë të kuptueshme për konsumatorin.
- Informacioni mund të deklarohet edhe si % Sasi Referencë për 100 g / ml ose për porcion, me kusht që në paketim të shfaqet deklarata "**Sasi referencë për një të rritur mesatar (8400 kJ / 2000 kcal)**"
- Informacioni i vlerave ushqyese që përsëritet në pjesën e përparme të ambalazhit nuk është e detyrueshme të jetë në të njëjtin format si në deklaratën kryesore